



FORÇA JONË

*** Viti IV • Nr. 35 • Qershor 2015 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ***

Ministri Haki Demolli dhe gjeneral Rrahman Rama takuan gjeneralin nga Turqia Erdal Ozturk

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama pritën në takim të përbashkët një delegacion të lartë ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në krye me gjeneralletjënant Erdal Ozturk. Ministri Haki Demolli, fillimisht, falënderoi gjeneralin Ozturk dhe nëpërmjet tij Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë për bashkëpunimin e shkëlqyer ndër-mjet dy forcave, dy ministrive dhe të dy vendeve tona. Gjithashtu, ministri Demolli tha se bashkëpunimi ynë në kuadër të marrëveshjes dypalëshe është duke u realizuar në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Ministria e FSK-së dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë të përkushtuara që ky bashkëpunimi të vazhdojë

edhe në të ardhmen, duke shprehur njëherësh mirënjohje për kontributin e gjithanshëm që Forcat e Armatosura të Turqisë po japin për shkollimin dhe trajnimin e pjesëtarëve, e gjithashtu edhe për mbështetjen me pajisje të nevojshme. Ministri Demolli po ashtu shprehur konsideratën e tij të lartë për kontributin e palodhshëm të Kontingjentit turk, i cili shërben në kuadër të KFOR-it, për sigurinë dhe paqen në vendin tonë. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së gjeneralletjënant Rrahman Rama pasi që falënderoi gjeneralin Ozturk për vizitën, tha se Forcat e Armatosura të Turqisë në vazhdimësi kanë treguar që janë partner i rëndësishëm për FSK-në, dhe se kontributi i Ushtrisë së Turqisë në shumë fusha ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në veçanti gjeneral Rama shprehur konsideratë për përmbushjen e planeve të shkollimit, trajnimit dhe mbështetjes, të cilat kanë dalë dhe do të dalin edhe në të ardhmen, bazuar në marrëveshjen dypalëshe që kemi aktualisht. Ndërsa gjeneralletjënant Erdal Ozturk, shef i Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë, ndër të tjera, gjatë fjalës së tij, tha se Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes me gatishmërinë më të madhe ka ofruar kapacitetet e saj në të mirë të zhvillimit profesional e operacional të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne, shtoi gjenerali Ozturk, në bazë të planit dhe marrëveshjes që kemi bashkë, do t'i shtojmë angazhimet tona që në të ardhmen të rrisim numrin e trajnimeve duke identifikuar edhe fusha të tjera të nevojshme për mbështetjen tuaj në këtë fazë, si



dhe në të ardhmen për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Pjesë e delegacionit të gjeneralletjënant Erdal Ozturk ishin edhe gjeneralletjënant Omer Pac, shef i Shëndetësisë në Forcat e

Armatosura të Turqisë dhe komandanti i GATA-s (Spital ushtarak), pastaj, kolonel Hasan Aydoglu atashe ushtarak i Republikës së Turqisë në Kosovë, kolonel Omer Demircioglu dhe kolonel Gyltekin Yarali.

Ministri Haki Demolli dhe gjeneral Rrahman Rama e pritën në takim gjeneralin gjerman Hans Werner Fritz



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama pritën në takim të përbashkët komandantin e Komandës së Forcave të Bashkuara për Operacione të Forcave të Armatosura të Republikës Federale Gjermane, gjeneralletjënant Hans Werner Fritz dhe delegacionin e tij. Në takim, ministri Demolli falënderoi gjeneralin gjerman Fritz për bashkëpunimin e frytshëm dhe të vazhdueshëm në mes MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë si dhe të dy Forcave. Ministri Demolli po ashtu u shpreh mirënjohës për mbështetjen dhe kontributin që ka dhënë Gjermania, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë në zhvillimin dhe

avancimin e kapaciteteve të FSK-së. Më tutje, ministri i FSK-së, Haki Demolli e njoftoi gjeneralin Hans Werner Fritz lidhur me zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për procesin nëpër të cilin po kalon kjo Forcë si dhe gjendjen e tanishme politike rreth transformimit të FSK në Forca të Armatosura. Zotëri Demolli tha se i gjithë ky proces është shumë transparent dhe se jemi shumë të gatshëm që kjo të bëhet në koordinim të përhershëm me vendet mike dhe partnere në proces. Ndërsa, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletjënant Rrahman Rama në takim foli rreth planeve për transformimin dhe zhvillimin e Forcës në të ardhmën, duke potencuar faktin se janë në proces përgatitjet si për strukturë

ashtu edhe për doktrinat, dhe se ky planifikim vazhdimisht është bërë dhe po bëhet në koordinim me Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s për FSK-në (NLAT) dhe me Ekipin Këshillues të NATO-s për MFSK-në (NAT). Gjeneral Rama në fund tha se FSK-ja si institucion shumetnik është e hapur dhe ne jemi duke ndërtuar një forcë për të gjithë qytetarët pa dallim. Edhe gjatë procesit të transformimit do të jemi transparent me të gjithë qytetarët e vendit, shtetet fqinje dhe me partnerët tanë. Komandanti i FSK-së, në përmbyllje të fjalës së tij theksoi se jemi të interesuar të ndërtojmë një Forcë fleksibile me standarde të NATO-s, dhe se synimi ynë është që të jemi vend anëtar me të drejta të plota në NATO. Nga ana e tij,

gjeneralletjënant Hans-Werner Fritz tha se Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes së Gjermanisë ka përcjellë nga afër zhvillimet në FSK dhe se do ta ndjek me vëmendje të veçantë edhe fazën e procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura. Gjenerali Fritz më tutje shtoi se ndjehet i lumtur që krerët e FSK-së kanë filluar një proces në mënyrë transparente dhe ai garantoj mbështetje të vazhdueshme për FSK-në si në pajisje ashtu edhe në trajnime dhe fusha tjera me interes reciprok. Në takim ishin të pranishëm edhe

gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, gjeneral brigade Werner Haumann, drejtor i NLAT-it, nënkolonel Rupert J.J Steeger, atashue ushtarak i Republikës së Gjermanisë në Kosovë, nënkolonel Michael Gierse, këshilltar gjerman në MFSK dhe nënkolonel Fadil Hoxha, asistent ushtarak i KOMFSK-së. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë janë duke i thelluar raportet e bashkëpunimit sipas marrëveshjes dypalëshe.



FSK-ja dhe Ushtria amerikane zhvilluan stërvitje të përbashkët

FAQE 4-5

Zëvendësministri i MFSK-së Fadil Gashi mori pjesë në Panairin e 12-të Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes në Turqi

Me ftesë zyrtare të Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, z. Ismet Jëlmaz nga data 04-09 maj 2015, delegacioni i MFSK-së i udhëhequr nga zëvendësministri i FSK-së Fadil Gashi, i shoqëruar nga atashet ushtarak i Kosovës në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani, shefi i Sektorit të Planeve, Programeve dhe Analizave në MFSK-së, nënkolonel Sefer Isufi mori pjesë në Panairin e 12 Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes në Stamboll.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm edhe Presidenti i Republikës së Turqisë, ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë dhe delegacione të larta ministrore dhe ushtarake të rreth 80 shteteve. Gjatë këtij qëndrimi zëvendësministri Fadil Gashi realizoi një varg takimesh me personalitete politike dhe ushtarake të vendeve të ndryshme. Takimi më i rëndësishëm ishte ai me homologun dhe nikoqirin e tij,

zëvendësministrin e Mbrojtjes së Turqisë zotin Hasan Kemal Jardëmxhë. Në këtë takim zëvendësministri Gashi vlerësoi lart mbështetjen e dhënë në të gjitha fushat nga ana e Qeverisë së Republikës së Turqisë, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Turqisë, në ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së. Zëvendësministri Jardëmxhë vlerësoi lart të arriturat e MFSK-së dhe FSK-së, duke shprehur fuqishëm gatishmërinë për

mbështetje të vazhdueshme dhe ngritjen e bashkëpunimit në mes dy vendeve mike, në mes të dy ministrive përkatëse si dhe Forcave të Armatosura të Turqisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë kësaj vizite zëvendësministri i FSK-së Fadil Gashi vizitoi edhe stafin e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stamboll, ai njëherësh takoi edhe shumë oficerë të FSK-së që gjenden për shkollim dhe trajnim në qendrat ushtarake në Stamboll.



Gjenerali Rrahman Rama priti ambasadorin e Shqipërisë Qemal Minxhozin

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama priti në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi, i cili në emër të shtetit shqiptar, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë e uroi komandantin Rama për detyrën e re. Gjenerali Rama duke falënderuar ambasadorin Minxhozi, vlerësoi lartë shkallën e bashkëpunimit në mes të dy shteteve, ministrive përkatëse si dhe FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ai theksoi se ky bashkëpunim ka qenë shumë i frytshëm sidomos në fushat e shkollimit, trajnimit dhe ushtrimeve të përbashkëta. Nga ana e tij ambasadori Minxhozi vuri në dukje nivelin e mirë të bashkëpunimit në mes të dy shteteve, duke pohuar se, thellimi i këtij bashkëpunimi nuk është vetëm në të mirë të dy shteteve tona, por edhe në të mirë të sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Me këtë rast ambasadori Minxhozi nënvizoi se përvojat e Shqipërisë si një vend anëtar i NATO-s do të jenë të dobishme edhe për Kosovën drejt objektivit të saj për të qenë anëtare e NATO-s.

Inspektori Gjeneral i MFSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari vizitoi Kroacinë dhe Slloveninë

Inspektori Gjeneral i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Bashkim Jashari, që nga data 13deri më 15 majë 2015, qëndroi për një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë.

Gjeneral brigade Bashkim Jashari së bashku me bashkëpunëtorët e tij u prit në Inspektoratin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë nga Inspektori Gjeneral i MMRK-së, gjenerallejtnant Mirko Sundov dhe zëvendës Inspektori Gjeneral, gjeneral brigade Slaven Zvilkov dhe stafi i gjerë i Inspektoratit. Gjatë takimit u shkëmbyen përvojat dhe njohuritë e të dy organizmave përkatës, si dhe u theksua nevoja e bartjes së përvojave dhe njohurive në kuadër të përmbushjes së standardeve monitoruese të nevojshme për integrim në NATO. Të dy Kryeinspektorët u pajtuan se bashkëpunimi dypalësh në këtë fushë është shumë i mirëpritur, duke pasur parasysh potencialin e përbashkët për bashkëpunim.

Gjatë qëndrimit në Kroaci, gjeneral Jashari i shoqëruar nga gjenerali Zdilari vizitoi Akademinë e Mbrojtjes së Kroacisë, ku u prit nga komandanti i saj, gjenerallejtnant Slavko Baric dhe stafi i lartë i Akademisë së Mbrojtjes. Gjatë kësaj vizite u prezantuan kapacitetet edukative, stërvitore dhe trajnuese. Të



dy gjeneralët biseduan për mundësinë e bashkëpunimit në këtë fushë, në mes të dy institucioneve. Ndërsa, në ditën e tretë të vizitës, gjeneral Jashari i shoqëruar nga gjenerallejtnant Sundov vizitoi industrinë ushtarake të Kroacisë, ku u njoftua mbi kapacitetet dhe mundësitë e bashkëpunimit në këtë fushë.

Inspektori Gjeneral i MFSK-së, gjeneral brigade Bashkim Jashari nga data 20 deri më 22 maj 2015, qëndroi për vizitë zyrtare edhe në Ministrinë e Mbrojtjes të

Republikës së Sllovenisë, përkatësisht në Inspektoratin e kësaj Ministrie. Gjenerali Jashari u prit nga Kryeinspektori M. Sc. Roman Zupanec, shefi i Divizionit Civil të Mbrojtjes së Sllovenisë M. Sc. Bojan Benedik si edhe inspektori i lartë kolonel Tomaz Okraslar. Gjatë takimit dypalësh ata diskutuan për çështje që i preokupojnë të dy inspektoratet përkatëse. Gjatë takimeve në Inspektoratin e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë u diskutua lidhur me funksionimin e përgjithshëm të inspektorateve, programet trajnuese të Inspektoratit të Sllovenisë, aktivitetet praktike të inspektimit dhe bashkëpunimi me organizmat tjera të mbikëqyrjes.

Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Jashari u prit edhe nga Sekretari Shtetëror i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë, Msc. M. Bizjak. Gjatë këtij takimi u bisedua për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, duke e cilësuar si mjaft të suksesshëm bashkëpunimin e deritashëm. Gjenerali Jashari këto vizita i cilësoi të dobishme, edhe për shkak të fazës në të cilën gjendet FSK-ja, ngase siç thotë Ai, "ne i kemi konfirmuar kapacitetet e nevojshme si Forcë të tanishme, dhe synimi ynë është bërja e mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm edhe për fazat e ardhshme, në të cilat ne si forcë mund të avancojmë.



Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë për Politikë dhe Plane në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë

Drejtori i Drejtorisë për Politikë dhe Plane nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), z. Faruk Geci mori pjesë në seminarin e nivelit më të lart strategjik, atë të gjeneralëve dhe ambasadorëve që u zhvillua në

Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-së në Romë të Italisë. Tematikë e këtij seminari ishin çështjet strategjike të zhvillimeve globale në fushën gjeopolitike, ekonomike dhe ushtarake në Evropë dhe SHBA. Gjatë një

jave sa edhe ka zgjatur ky seminar është biseduar edhe për ndërlikohen me krizën në Ukrainë dhe Rusi, Lindje të Mesme dhe Afrikë Veriore si dhe çështjet e ngritjes ekonomike dhe ushtarake të Kinës.

Gjeneral brigade Enver Cikaqi mbajti ligjëratë për ushtarakët amerikanë në "Bondsteel"



Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi me ftesë të Komandantit të Grupit Luftarak Shumëkombësh Lindje „Bondsteel”, kolonelit Clinton Baker mbajti një ligjëratë për ushtarakët amerikanë në kampin „Bondsteel” në Sojevë me temën "Përvoja dhe perspektiva personale si pjesëmarrës i UÇK-së, Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK) dhe FSK-së". Komandanti i KDS, gjeneral Cikaqi iu drejtua një audience të gjerë të oficerëve dhe nënoficerëve të lartë të Grupit Luftarak Shumëkombësh Lindje, në kudër të KFOR-it, të cilët treguan interesim të lartë për të dëgjuar ligjëratën dhe tematikën e shpjelluar.

Ligjëratë ishte fokusuar kryesisht në një historik të shkurtër të Kosovës para fillimit të luftës së UÇK-së, fillat e organizimit të luftës, pastaj transformimi i UÇK-së në TMK, shuarjen e TMK-së dhe ngritjen e FSK-së dhe vazhdimi i rrugës drejt përm-

bushjes së ëndrrës shekullore për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Fokusi i ligjëratës së gjeneralit Enver Cikaqi ishte tek bashkëpunimi me miqtë ndërkombëtarë gjatë këtyre periudhave të vështira nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe institucionet e saj, e në këtë kuadër edhe sfidat me të cilat është ballafaquar UÇK-TMK-FSK gjatë transformimit e deri në ditët e sotme në pritje të misionit të ri. Komandanti i KDS-së, gjeneral Enver Cikaqi, me këtë rast tha: "Do ta veçoja kontributin e Ushtrisë amerikane e cila vazhdimisht ka shprehur gatishmërinë që të ofrojë mbështetje për FSK-në, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturës, duke na mbështetur me trajnime brenda dhe jashtë vendit, e gjithashtu edhe në aspektin logjistik ku ka dhënë një kontribut të madh". Gjenerali më pas theksoi edhe rolin e shteteve tjera anëtare të NATO-s, të cilat kanë treguar përkushtim për ngritjen e një force të aftë e profesionale siç është FSK-

ja. Gjatë kësaj periudhe, vazhdoi gjeneral Cikaqi, KDS-ja ka bashkëpunuar me Grupin Luftarak Shumëkombësh Lindje (Bondsteel), të cilët kanë ofruar mbështetje me instruktorë për realizimin e trajnimeve aty ku kemi pas mundësi dhe programe të cilat kemi arrit që t'i adaptojmë për nevojat e FSK-së, pohoi në ligjëratën e tij gjeneral Cikaqi. Gjithashtu, gjatë prezantimit, gjenerali foli edhe për të ardhmen e Forcave të Armatosura të Kosovës si një vazhdimësi e historisë së institucionit të uniformuar dhe trajnuar në mënyrë të specializuar në të gjitha lëmit ushtarake. Ushtria amerikane është partner strategjik i FSK-së tash, besoj se kështu do të jetë edhe në të ardhmen, atëherë kur të jemi Forca të Armatosur të Kosovës, dhe besojmë që Kosova së shpejti do të jetë vend kontribues i paqes dhe jo vetëm konsumues i saj.

Komandanti i Bondstillit, kolonel Clinton Baker falënderoi komandantin e KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqin për kontributin e tij me këtë ligjëratë para ushtarakëve amerikanë, ndërsa audience e mirëpriti ligjëratën e komandantit të KDS-së, dhe në fund u shtruan një varg pyetjesh të cilave gjenerali iu përgjigj. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Grupi Luftarak Shumëkombësh Lindje (Bondsteel) vazhdojnë të zhvillojnë një bashkëpunim të shkëlqyer në shumë fusha me interes të përbashkët.



Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama homazhe në nderim të dëshmorit Luan Haradinaj

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Drejtorisë për Operacione dhe Trajnime në MFSK, kolonel Naim Haziri shef i Shtabit të Komandës së Forcave

Tokësore si dhe oficerë dhe zyrtarë të MFSK-së dhe FSK-së, në përvjetorin e 18 të rënies së dëshmorit të kombit Luan Haradinaj sot ishin në Deçan. Ata bënë homazhe dhe vendosën lule të freskëta në shenjë nderimi dhe përkujtimi të luftës heroike të dëshmorit luan Haradinaj si dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.

Shefi i Shtabit të Komandës Tokësore të FSK-së, kolonel Naim Haziri priti një delegacion të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, koloneli Naim Haziri së bashku me bashkëpunëtorë, priti një delegacion të oficerëve të lartë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të prirë nga nënkolonel Ulsi Rexhaj, komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), nënkolonel Lutfi Shahini, nënkolonel Nexhmi Vrenezi, nënkolonel Isuf Lushaj dhe kapiten Edvin Nure. Delegacioni i FARSH-it po qëndron për në një vizitë pune në MFSK/FSK, ku po punon rreth zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara në fushën e ndërlidhjes FARSH-FSK, për vitin 2015. Shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Haziri

e njoftoi delegacionin e FARSH-it me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Ai, mes tjerash gjatë takimit tha: "Ndiheja me FARSH është e pakursyer në të gjitha fushat drejt realizimit të misionit tonë si shtet dhe si Forcë e Republikës së Shqipërisë, të prirë nga nënkolonel Ulsi Rexhaj, komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), nënkolonel Lutfi Shahini, nënkolonel Nexhmi Vrenezi, nënkolonel Isuf Lushaj dhe kapiten Edvin Nure. Delegacioni i FARSH-it po qëndron për në një vizitë pune në MFSK/FSK, ku po punon rreth zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara në fushën e ndërlidhjes FARSH-FSK, për vitin 2015. Shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Haziri

me të arriturat e përgjithshme të FSK-së. Ai, mes tjerash gjatë takimit tha: "Ndiheja me FARSH është e pakursyer në të gjitha fushat drejt realizimit të misionit tonë si shtet dhe si Forcë e Republikës së Shqipërisë, të prirë nga nënkolonel Ulsi Rexhaj, komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), nënkolonel Lutfi Shahini, nënkolonel Nexhmi Vrenezi, nënkolonel Isuf Lushaj dhe kapiten Edvin Nure. Delegacioni i FARSH-it po qëndron për në një vizitë pune në MFSK/FSK, ku po punon rreth zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara në fushën e ndërlidhjes FARSH-FSK, për vitin 2015. Shefi i Shtabit të KFT-së, koloneli Haziri

Oficerët e FARSH-it punuan edhe në ngritjen e rrjetit të komunikimit. Në fund, kolonel Haziri falënderoi oficerët e FARSH-it, për kontributin e dhënë në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së në të gjitha fushat.

FSK-ja në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Ferid Agani, pjesëtarë të FSK-së, nxënës të shkollave fillore të Prishtinës dhe qytetarë-vullnetarë të tjerë, si dhe përfaqësues të shoqatave joqeveritare morën pjesë në aksionin "Ta Pastrojmë Kosovën", në lagjen "Arbëria 3" të Prishtinës, të organizuar nga Iniciativa "Ta Pastrojmë Kosovën". Komandantit i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast, përshëndeti pjesëmarrësit e aksionit për pastrimin e ambientit, nxënësit e shkollave fillore, ushtarët e FSK-së dhe qytetarët e Kosovës. Ai gjatë fjalimit të tij ndër të tjera tha: "Këtë aktivitet e kemi bërë tashmë tradicional në gjithë Kosovën. Sot, po marrim pjesë dhe po kontribuojmë sado pak në

pastrimin e ambientit sepse është në të mirën e qytetarëve, në të mirën e fëmijëve tanë dhe pasardhësve tanë" -tha në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Ndërsa, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferid Agani, me këtë rast theksoi: "Është një thënie që mjedisi është pasqyra jonë, unë jam i bindur që fytyra jonë nuk është kjo që po e shohim përreth dhe përfundimisht duhet bërë atë që e bënë çdo njeri në mjedisin ku jeton. Kjo sot që po e shohim është një dëshmi e fuqisë së qytetarisë së Kosovës, e rinisë së Kosovës dhe kjo më bënë shumë optimist që në ditët e ardhshme do ta kemi shtetin tonë ashtu siç jemi vet".

Edhe koordinatori i Iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj tha: "Jemi sot këtu për ta hapur aksionin "Ta pastrojmë Kosovën" së bashku me ministrin e mjedisit, gjeneralin e FSK-së dhe kryetarin e Green Art Center, dhe me ata që më së shumti i kontribuojnë këtij aksioni që janë këta 500 fëmijë vullnetarë që edhe në këtë ditë me



shi, po i bashkohen aksionit për largimin e mbeturinave. Presim mbi 50 mijë vullnetarë që të jenë sot në aksion dhe shpresojmë që përfundimisht duhet ta ndërtojmë qasjen ndaj mjedisit. Si qytetarët, institucionet dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë dhe përfundimisht mjedisi jonë të duket ashtu si i ka hije. Në këtë aksion, këtu në Prishtinë, po marrim pjesë mbi 500 fëmijë së bashku me pjesëtarë të FSK-së. Aksioni për pastrimin e ambientit po zhvillohet në njëjtën kohë në gjithë territorin e Kosovës" FSK-ja në këtë aksion i cili u zhvillua anë e kënd Kosovës si në Prishtinë, Istog, Shkabaj, Ferizaj, Mitrovicë, Liqeni i Badovcit etj., mori pjesë me një numër të caktuar ushtarësh dhe me dhjetëra automjete si kamionë dhe ekskavatorë.



FSK-ja dhe Ushtria e SHBA-ve zhvilluan stërvitje të përbashkët

Brigada për Reagim të Shpejtë dhe njësitë tjera të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim dhe asistencë të Ushtrisë amerikane për Evropë dhe Komandës amerikane për Evropë zhvilluan me sukses stërvitjen e përbashkët „Ndihma e Kosovës”, në Aeroportin fushor të Gjakovës.

Aktivitetet e operacionit i pa nga afër edhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Rrahman Rama, i cili me këtë rast i përgëzoi udhëheqësit e operacioneve dhe pjesëtarët që në mënyrë profesionale realizuan të gjitha pjesët e skenarit të ushtrimit.

Gjithashtu, gjeneral Rama tha se FSK-ja për here të parë është stërvitur për tërheqjen e ndihmave humanitare, për here të parë është stërvitur për manovrim të ndihmave të lëshuara nga ajri nëpërmjet aeroplanëve dhe helikopterëve, përvojë kjo e cila do t'i nevojitet, në raste emergjente kur kërkohet angazhim humanitar. Në fund komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, deklaroi se kjo stërvitje ka rëndësi sepse FSK-ja me këtë ushtrim është stërvitur për ndërveprim me Ushtrinë amerikane, por edhe për ndërveprime me partnerë dhe institucione tjera në raste emergjencash dhe atëherë kur paraqitet nevoja. Majori Jason Wayne, oficer për Operacione i Brigadës 40 të Parashutistëve, Divizioni i 25 i Këmbësorisë nga Alaska e ShBA-ve, njëherësh nga Ushtria amerikane për Evropë, e vlerësoi lartë bashkëpunimin ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë



amerikane për Evropë. Ai tha se Forcat Ajrore amerikane kanë ardhur sot këtu nga Gjermania dhe kanë lëshuar pakot si pjesë e ushtrimit. Ky demonstrim me aeroplanët e tipit C130J ka treguar se ndërveprimi ndërmjet dy partnerëve ishte i shkëlqyer dhe se Forca e Sigurisë së Kosovës është mjaft profesionale.



Qëllimi i ushtrimit „Ndihma e Kosovës” ka qenë që FSK-ja të trajnohet në mënyrë që të asistojë autoritetet civile gjatë emergjencave dhe fatkeqësive natyrore apo emergjencave tjera që kërkojnë asistencë humanitare.

Në këtë ushtrim për herë të parë u përdorën për qëllime ushtrimi aeroplanë të Forcave Ajrore amerikane të tipit C130J, të cilët nga Ramshtajni i Gjermanisë fluturuan për në Aeroportin të Gjakovës. Ushtrimi u realizua nga Forca e Sigurisë së Kosovës e cila udhëhoqi me ushtrimin dhe u zhvillua me asistimin e Brigadës së Katërt të Këmbësorisë Parashutiste Luftarake nga Alaska

e Shteteve të Bashkuara të Amerikës(ShBA), aktualisht e bashkangjitur Ushtrisë amerikane për Evropë, si dhe Komandës së SHBA-ve për Evropë(UCECOM). Roli i Ushtrisë amerikane për Evropë në këtë ushtrim ishte; asistencë në planifikim, burime trajnuese dhe ekspertizë teknike. Të pranishëm gjatë zhvillimit të ushtrimit; „ Ndihma e Kosovës”, ishin të pranishëm, zëvendësiministri Fadil Gashi, Ud/komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, komandanti i Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë, nënkolonel Mehmet Lladrovci si dhe oficerë të tjerë të lartë të FSK-së dhe Ushtrisë amerikane për Evropë.



FSK në Garën për zgjedhjen e ushtarit më të mirë në Kroaci

Për herë të parë Forca e Sigurisë së Kosovës mori pjesë dhe përfundoi me sukses Garën për zgjedhjen e ushtarit më të mirë të Forcave të Armatosura të Kroacisë. Garat u mbajtën në zonën e trajnimit ushtarak "Eugen Kvaternik" në Slunj të Kroacisë veriore. FSK-në e përfaqësuan Tetarët Binak Podrimçaku dhe Feti Pronaj së bashku me 151 pjesëmarrës të tjerë nga 10 shtete të ndryshme të botës. Gara është mbajtur në periudhën prej dy ditësh, 20 dhe 21 maj, si dhe përfshiu përfundimin e kursit prej 46 kilometrave mbi ter-

renin sfidues dhe kalimin e 13 pengesave në shteg. Gara ishte dizajnuar të demonstrohen përgatitjet individuale, njohuritë ushtarake, shkathtësitë individuale, si dhe përgatitja fizike dhe mentale. As kushtet e vështira atmosferike përgjatë garës, nuk ndalën paraqitjen e jashtëzakonisht të pjesëmarrësve të FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses dhe të jenë në mesin e më të mirëve, ku Tetari Feti Pronaj u rendit i 4-ti, nga pjesëmarrësit ndërkombëtarët, duke e pasur parasysh se gjysma e pjesëmarrësve nuk arritën ta përfundojnë garën. "Kjo ishte një ngjarje e shkëlqyeshme për pjesëtarët e FSK-së, sepse gati gjysma e të gjithë pjesëmarrësve nuk e përfunduan garën" tha nënkolonel David Jones, këshilltar i Komandantit të FSK-së, i cili ndër të tjera shtoi " Unë, me të vërtetë jam këren për përpjekjet e pjesëtarëve të FSK-së si dhe të dy pjesëmarrësve të cilët, vërtetë dolën mirë. Kjo ishte për shkak të profesionalizmit, përcaktimit dhe shpirtit ekipor të individit" theksoi në fund, nënkolonel David Jones.

renin sfidues dhe kalimin e 13 pengesave në shteg. Gara ishte dizajnuar të demonstrohen përgatitjet individuale, njohuritë ushtarake, shkathtësitë individuale, si dhe përgatitja fizike dhe mentale. As kushtet e vështira atmosferike përgjatë garës, nuk ndalën paraqitjen e jashtëzakonisht të pjesëmarrësve të FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses dhe të jenë në mesin e më të mirëve, ku Tetari Feti Pronaj u rendit i 4-ti, nga pjesëmarrësit ndërkombëtarët, duke e pasur parasysh se gjysma e pjesëmarrësve nuk arritën ta përfundojnë garën. "Kjo ishte një ngjarje e shkëlqyeshme për pjesëtarët e FSK-së, sepse gati gjysma e të gjithë pjesëmarrësve nuk e përfunduan garën" tha nënkolonel David Jones, këshilltar i Komandantit të FSK-së, i cili ndër të tjera shtoi " Unë, me të vërtetë jam këren për përpjekjet e pjesëtarëve të FSK-së si dhe të dy pjesëmarrësve të cilët, vërtetë dolën mirë. Kjo ishte për shkak të profesionalizmit, përcaktimit dhe shpirtit ekipor të individit" theksoi në fund, nënkolonel David Jones.



Pjesëtarë të FSK-së certifikohen në kursin "Sistemi i Informimit Gjeografik"

Në ambientet e kazermës "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, 21 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës kryen kursin "Sistemi i Informimit Gjeografik". Me këtë rast shef i Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Fadil Hadërgjonaj, tha: "Pas shumë përpjekjesh dhe angazhimesh arritëm që ta fusim në funksion këtë kurs i cili është realizuar falë angazhimit të instruktorëve të QSK-së, të cilët me përkushtim të lartë kanë punuar gjatë tërë javës sa ka zgjatur kursin. Ndërsa motivimi i pjesëtarëve të

FSK-së është për t'u admiruar, ka qenë një përkushtim dhe disiplinë e lartë nga ana e tyre. Ky program do t'i shërbejë FSK-së shumë në të ardhmen. Ne do të bëjmë përpjekje që ta avancojmë edhe më shumë, por e rëndësishme është që pjesëtarët të cilët e kanë vijuar këtë kurs vijnë nga njësi të ndryshme të FSK-së dhe kanë mundësi që njohuritë e marra t'i shpërndajnë të kolegët e tyre dhe kështu kursi do ta ketë efektin e plotë". Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore (KFT) kolonel Naim Haziri, kolonel Skënder Hoxha nga Ministria e FSK-së, shefi i

Shtabit të KDS-së, kolonel Fadil Hadërgjonaj si dhe oficerë tjerë të FSK-së. Ndërsa komandanti i QSK-së, major Naim Sylejmani, lidhur me rëndësinë e këtij kursi u shpreh: "Ky kurs i ka të veçantat e tij për shkak se po realizohet për herë të parë në FSK, duke zbatuar programin e zhvilluar të teknologjisë informative me tendencë të zhvillimit dhe avancimit të këtij programi". Në fund koloneli Naim Haziri, Fadil Hadërgjonaj, Bashkim Shillova dhe major Naim Sylejmani ndanë certifikatë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së të cilët ishin pjesëmarrës të kursit Sistemi i Informimit Gjeografik.



Në FSK u mbajtën garat për zgjedhjen e ushtarit më të mirë

Migjen Shala, ushtari më i mirë i FSK-së, për vitin 2015"

Në një ceremoni solemne të organizuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtnant Rrahman Rama ndau çmimin „Ushitari më i mirë në FSK për vitin 2015", i cili çmim për këtë vit i takoi ushtarit Migjen Shala. Aktiviteti i shpalljes së rezultateve të garës për „Ushtarin më të mirë 2015", u mbajt në Komandën e Brigadës për Mbështetje Operacionale, me ç'rast u ndanë tri çmimet e para dhe me nga një mirënjohje u nderuan të gjithë garuesit. Në ceremoni morën pjesë oficerë të lartë të FSK-së, si dhe oficerë dhe nënoficerë ndërkombëtarë. Në fjalën e tij të rastit gjeneral Rama u shpreh se ndjehet tejet i lumtur që ushtarët të cilët kanë garuar gjatë këtyre ditëve kanë treguar profesionalizëm, përkushtim dhe njohuri shumë të mira të shkathtësive ushtarake.



Komandant Rama më tej shtoi: „ Bazar në rezultatet e arritura mund të them se ne të gjithë jemi fitues, e gjithashtu ju keni dëshmuar që ne si forcë e re jemi në rrugë të mirë të ngritjes së kapaciteteve tona dhe ushtarët tanë janë të përgatitur, të motivuar dhe të gatshëm të marrin përgjegjësi të reja." Në vazhdim, gjenerallejtnant Rrahman Rama iu drejtua ushtarëve që sfiduan këtë garë me këto fjalë: „Ushtarë të nderuar, ju me përkushtimin e dhënë gjatë kësaj gare jeni bërë shembull për të gjithë ushtarët e tjerë. Gjithashtu, ju keni vendosur standarde të larta për të gjithë ushtarët e tjerë." Në fund të fjalës së tij, gjeneral Rama tha: „Vetëm kështu, duke i ngritur standardet ne ecim drejt përmirësimit dhe zhvillimit të forcës. Jam i bindur që ky shpirt garues do të vazhdojë të rritet dhe përcillet tek gjeneratat e reja që do të vijnë pas jush." Në aktivitetin solemn me rastin e

shpalljes së rezultateve të garës: „Ushitari më i mirë 2015", foli edhe rreshter majori i FSK-së Genc Metaj, i cili së bashku me rreshterët e brigadave dhe njësitëve ishte i angazhuar gjatë gjithë kohës së zhvillimit të garës në njësi, brigada dhe në fund në nivel të FSK-së. Rreshteri Metaj tha se ndjehet i lumtur që gara e vitit 2015 ka shkuar mbarë dhe se rezultatet e arritura sot po prezantohen këtu para të gjithë eprorëve dhe se kjo garë është motivim për ushtarakët e FSK-së. Në fund të ceremonisë u shpallën edhe emrat e fituesve të garës, ku në vendin e parë sipas rezultateve të arritura në të gjitha disiplinat u përzgjedh ushtari Migjen Shala nga Brigada për Mbështetje Operacionale, në vendin e dytë ushtari Besnik Nebihu nga po e njëjta brigadë, dhe ushtarit më të mirë është organizuar për herë të dytë në FSK. Garën e vitit të kaluar e pati fituar tatar Binak Podrimçaku, i cili në këtë muaj do të marrë pjesë në garën ndërkombëtare të ushtarëve më të mirë që do të mbahet në Republikën e Kroacisë.



Drejtori i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK), kolonel Ilir Qeriqi mori pjesë në Konferencën "Kosova dhe fqinjët në perspektivën e integritimit Euro-Atlantike, bashkëpunimi regional dhe sfidat e sigurisë", organizuar

Konferenca Ndërkombëtare "Kosova dhe fqinjët në perspektivën e integritimit Euro-Atlantike..."

Kolonel Ilir Qeriqi mbajti kumtesën Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe sfidat e integritimit të FSK-së në NATO

nga Akademia Diplomatike e Kosovës, mbajtur në Pejë. Kolonel Qeriqi, në Konferencën për Kosovën dhe fqinjët, ishte njëri ndër panelistët dhe mbajti kumtesën, me temën: "Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal dhe sfidat e integritimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Me këtë rast të pranishmit janë njoftuar me fushat e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal të FSK-së me shtetet partnere me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së dhe sfidat me të cilat FSK po përballë në rrugën për integritim në strukturat Euro-Atlantike. Kjo konferencë ishte një mundësi e mirë për të

diskutuar me diplomatët rreth qasjeve të tyre për temat e shtjelluara si dhe një mundësi e mirë për të dëgjuar perspektivën e ligjëruesve me provojë, siç ishin: Rouse, Marie Dicarolo-ish ambasadore e SHBA-ve në OKB, Wolfan Petriq, diplomat i njohur, si dhe ligjërues të tjerë nga Marshal Center dhe nga Akademia Diplomatike Eminente. Kolonel Qeriqi theksoj, se "Konferenca "Kosova dhe fqinjët në perspektivën e integritimit Euro-Atlantike, bashkëpunimi regional dhe sfidat e sigurisë" është shumë e rëndësishme pasi që janë debatuar dhe mbajtur kumtesa për këndvështrime të ndryshme

në lidhje me sfidat e bashkëpunimit rajonal dhe Euro-Atlantike, si dhe objektivat e sigurisë së NATO-s. Në këto rrethana operacionet dhe veprimet e operimit në një mjedis të pasigurt dhe kompleks duhet të kenë një qasje gjithëpërfshirëse-DIME (Diplomatike, Informacione, Ushtarake, Ekonomike), që mund të ndihmojnë në këtë situatë të ndërlikuar dhe të pashembullt të sigurisë. Kumtesa e kolonel Qeriqit e prezantuar para diplomatëve të rinj gjatë konferencës u ndoqën me interesim të veçantë edhe për shkak të aktualitetit tematik por edhe për mënyrën si u prezantuar

nga ligjëruesi duke zbatuar forma të angazhimit interaktiv të pjesëmarrësve. Në Konferencë morën pjesë edhe diplomatë nga Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Turqia etj, si dhe diplomatë e zyrtarë të lartë të Kosovës. Nga FSK-ja, morën pjesë diplomatët e rinj, kolonel Xhavit Sadrija, atashë i FSK-së në Gjermani, nënkolonel Enver Dugolli, atashë në Shqipëri, nënkolonel Ahmet Ajeti atashë në Bruksel, major Sefer Shyti atashë në Suedi dhe nënkolonel Bekim Osmani atashë në Turqi. Në fund, pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata përkatëse të cilat u shpërndanë në mënyrë solemne.

Instrukturët e FSK-së u certifikuan nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina"

Në ambientet e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës(UP), në një ceremoni të veçantë u krye certifikimi i 25 instruktorëve të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në aktivitetin e ndarjes së certifikatave si rezultat i përfundimit të trajnimit tremujor me tematikë; "Qasja didaktike në punën me të rritur" morën pjesë: komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Ramadan Zejnullahu, dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Drita Kadriu, profesor dhe studentë të Fakultetit të Edukimit si dhe oficerë dhe nënoficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, gjeneral

Enver Cikaqi në emër të KDS-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës falënderoi rektorin Zejnullahu, dekanët Çeku dhe Veselaj si dhe tërë stafin akademik të Fakultetit të Edukimit për punën e pakursyer në të mirë të përfundimit me sukses të trajnimit tremujor për instruktorët e FSK-së. Më tej gjeneral Cikaqi tha se ky trajnim do të shërbejë që instruktorët e FSK-së të kenë mundësi që metodat e reja didaktike t'i aplikojnë gjatë trajnimeve dhe punës me pjesëtarët e FSK-së. Komandanti i KDS-së në fund të fjalës së tij tha gjithashtu se bashkëpunimi në mes Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së dhe Fakultetit të Edukimit të UP-së është i një rëndësie të veçantë dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Nga ana e tij rektori i Universitetit të Prishtinës „ Hasan Prishtina",

prof. dr. Ramadan Zejnullahu u shpreh se ndjehet tej i lumtur që Universiteti i Prishtinës ka ofruar këtë program për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe u zotua se institucioni që ai drejton është i hapur për bashkëpunim edhe në të ardhmen. Gjithashtu, në ceremoninë e certifikimit të instruktorëve foli edhe dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku i cili tha se Fakulteti i Edukimit dhe ai personalisht e kanë për nder që gjatë kësaj periudhe sa ka zgjatuar trajnimin, por edhe në raste tjera, të punojnë ngushtë me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dekani Çeku tha gjithashtu se fakulteti që ai drejton është i gatshëm të bashkëpunojë edhe në të ardhmen. Në fund të ceremonisë, rektori Zejnullahu dhe dekani Çeku ndanë certifikata për 25 pjesëtarët



e FSK-së të cilët punojnë si instruktorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, e të cilët për tre muaj ndoqën këtë trajnim. Pastaj, gjeneral Enver Cikaqi në emër të KDS-së dhe FSK-së, për realizuesit e këtij projekti, ndau nga një mirënjohje në shenjë respekti për kontributin e pedagogëve gjatë gjithë kursit. Trajnimi „Qasja didaktike në punë me të rritur" ka zgjat tre muaj dhe gjatë kësaj kohe

janë trajtuar temat si: „Modalitetet e vlerësimit në teori dhe në praktikë", "Aspektet psikologjike të vlerësimit", „Strategji bashkëkohore të mësimdhënies" etj. Të 25 instruktorët e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, me këtë trajnim kanë përfutur njohuri të reja për punën e tyre të përditshme për realizimin me sukses të kurseve dhe trajnimeve në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Batalioni i Xhenios i FSK-së me projekte të rëndësishme në shërbim të qytetarëve

Batalioni i Xhenios i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) të FSK-së, këto ditë, është angazhuar në realizimin e dy projekteve të ndryshme, në atë të tërheqjes së urës në fshatin Kramovik të Klinës dhe largimin e telave gjemborë nga rrethoja e Kishës Ortodokse në Prizren. Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios, urën mobile, e cila është pronë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me një gjatësi prej 52 metrash dhe me peshë mbi 75 tonelata, qysh në muajin korrik të vitit 2013 e patën montuar mbi lumin "Drini i



Bardhë" në aksin rrugor Gjakovë-Klinë, pas vërshimeve të cilat e patën dëmtuar urën kryesore mbi këtë lumë. Që nga korriku i vitit 2013, ura e FSK-së ka shërbyer për të gjitha automjetet të cilat kanë kaluar aksin rrugor Gjakovë-

Klinë dhe anasjelltas. Tani pas meremetimit të urës në rrugën kryesore dhe lëshimit të saj në qarkullim të automjeteve, ura mobile e FSK-së nuk është më funksionale. Për këtë, sipas planit dinamik të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zhvendosja e saj ka filluar më 12 maj 2015 dhe pritet të përfundojë në një afat prej 12 ditësh, ku ura e çmontuar do të dërgohet në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, me qëllim që të jetë në gatishmëri të plotë në të ardhmen dhe të përdoret në shërbim të popullatës kudo që të ketë nevojë.



Në këtë operacion janë angazhuar gjithsej 27 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios të Komandës dhe Doktrinës së Stërvitjes dhe të Batalionit të Mjekësisë. Ndërsa, në projektin e dytë, në atë të largimit të rretho-

jave gjembore nga Kisha Ortodokse në Prizren, që ka filluar të hënen më 18 maj, pritet të përfundojë të premten më 22 maj. Në këtë projekt po marrin pjesë 15 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios me 5 automjete.

Në FSK u mbajt seminari "Operacionet e stabilitetit"

Në repartet e Policisë së Forcës në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët vijuan seminarin me temë: „Operacionet e Stabilitetit”. Ky seminar i zhvilloi punimet nga data 5 deri më 7 maj 2015 nën udhëheqjen e marinsave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij gjatë ceremonisë tha: „Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar dhe do të vazhdojë të punojë dhe të bashkëpunojë me partnerët e saj strategjikë, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera”. Gjeneral Rama tha gjithashtu se FSK-ja është duke u angazhuar që të krijojë një standard adekuat për ndërveprim në të



ardhmen, në mënyrë që në rastet kur merr ftesë për angazhime në operacione paqësore të jetë e gatshme. Ne, shtoi gjeneral Rama, asnjëherë nuk e harrojmë mbështetjen e vendeve demokratike për Kosovën, prandaj për këtë qëllim përgatitemi që me kapacitetet tona

të japim kontributin që do të na kërkohej. Në fund të fjalës, gjeneral Rama i përgëzoi oficerët dhe nënoficerët e FSK-së për angazhimin dhe seriozitetin e treguar e gjithashtu edhe për shkathhtësitë profesionale të paraqitura në këtë seminar. Po ashtu, komandanti i FSK-së, në veçanti i

falënderoi ushtarakët e Marinës të SHBA-ve, kapitenin Ryan P. Behan dhe kapterin (Gy.Sgt) Patrick C.Cochrane, si dhe Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë, për kontributin e dhënë në mbarëvajtjen e seminarit dhe ndarjen e eksperiencave me oficerët dhe nënoficerët e FSK-së pjesëmarrës në këtë trajnim. Gjeneral Rama, në shenjë falënderimi, ndau mirënjohje për të dy ushtarakët e Marinës së SHBA-ve, të cilët për tri ditë punuan bashkërisht me oficerët e FSK-së në mbarëvajtjen e seminarit. Nga ana e tij, instruktori i marinsave amerikanë, kapiteni Ryan P. Behan tha se ndjehet i lumtur që FSK-ja ka oficerë kaq profesional dhe bashkëpunues, dhe se gjatë gjithë seminarit në tha kapiten Behani kemi shkëmbyer përvoja, kemi treguar eksperiencat tona nga fusha e operacioneve të

stabilitetit si dhe kemi marrë shumë njohuri edhe nga përvoja e oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së. Për përfundimin me sukses të seminarit, për 30 oficerë të shtabeve dhe nënoficerë të FSK-së u ndan certifikata.

Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm edhe atasheu i Mbrojtjes i SHBA-ve pranë Ambasadës amerikane, kolonel Chad Butts, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK etj. Bashkëpunimi i mirë në fushën e trajnimeve dhe profesionalizimeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës po avancohet çdo ditë e më shumë, bashkëpunim ky i cili po zhvillohet suksesshëm në koordinim me Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë dhe përfaqësuesit ushtarak amerikan të angazhuar pranë saj.

Brigada e Reagimit të Shpejtë realizoi ushtrimin "Ujku Garues 2015"

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, për herë të parë u mbajt ushtrimi "Ujku Garues 2015", në nivel të BRSH-së, ku garuesit u sfiduan në shkathhtësitë profesionale dhe fizike.

Në këtë ushtrim morën pjesë gjithsej 50 pjesëtarë; një ekip nga Komanda e BRSH-së dhe nga tri ekipe të Batalioneve 1, 2 dhe 3 të BRSH-së. Disiplinat në të cilat u sfiduan garuesit ishin: vrapimi 3.2 km, hedhja e granatës së dorës, shtyrja e autobлиндës, vëzhgimi, kalimi i zonave të minuara dhe kalimi mbi zona të rrezikshme.

Në përcjellje të ushtrimit ishin prezent edhe ushtruesi i detyrës së Komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir Geci, komandanti i

Batalionit 2-të të Reagimit të Shpejtë nënkolonel Mehmet Lladrovci, ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci, stafi i komandës së BRSH-së dhe i tri batalioneve. Kolonel Geci, me rastin e adresimit të pranishmëve dhe pjesëmarrësve në garë, ndër të tjera tha: "Përgatitja e pjesëtarëve të BRSH-së në ngritjen e shkathhtësive profesionale është domosdoshmëri dhe kusht që, ne, si Brigadë e Reagimit të Shpejtë të jemi në nivelet më të larta të përgatitjes profesionale".

Synimi kryesor i organizimit të kësaj gare, nga Shefi i Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci dhe rreshter majori i parë Shefqet Hasani ishte që pjesëtarët e BRSH-



së të sfidoheshin në disiplinat e lartcekura në mënyrë që të dëshmonin përgatitjen fizike dhe mentale. E gjithashtu, kjo garë është realizuar me qëllim të motivimit të pjesëtarëve të BRSH-së për ngritjen e vazhdueshme të shkathhtësive profesionale me qëllim që Brigada e

Reagimit të Shpejtë të jetë më e përgatitur profesionalisht që t'i shërbejë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në fund të ushtrimit "Ujku Garues 2015", në bazë të rezultateve të arritura; vendin e parë e zuri Ekipi i 3-të i Batalioni të Parë të Reagimit



të Shpejtë, (RSH), vendin e dytë Ekipi i 2-të i Batalionit të Parë të RSH, dhe në vendin e tretë u rendit Ekipi i 3-të i Batalionit të Tretë të RSH. Vendi i parë u shpërblye me Emblemën e BRSH-së dhe Mirënjohje, ndërsa vendi i dytë dhe i tretë me Mirënjohje.

U certifikuan pjesëmarrësit e trajnimit "Taktika me njësitë e vogla"

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë në kazermën e FSK-së, "Ushtarët e NATO-s" në Istog, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama bëri një vizitë pune me rastin e ceremonisë së certifikimit të 50 pjesëtarëve të gjeneratës së dytë, të cilët përfunduan me sukses trajnimin pesë javor „Taktika me njësitë e vogla”. Duke ju drejtuar ushtarëve të certifikuar komandant Rama ndër të tjera tha se ushtarët dhe nënoficerët të cilët janë stërvitur gjatë këtij trajnimit



kanë treguar përkushtim dhe kanë marrë njohuri të reja në shkathhtësitë ushtarake të nevo-

jshme në njësitë e vogla". Duke vazhduar fjalën e tij më tej shtoi: "Ju me këtë po dëshmoni që ne si

forcë e re jemi në rrugë të mirë të ngritjes së kapaciteteve tona dhe pjesëtarët tanë janë të përgatitur, të motivuar dhe të gatshëm për të marrë përgjegjësi të reja?. Me këtë rast ai uroi dhe përgëzoi ushtarët për përfundimin me sukses të këtij trajnimit, po ashtu ai falënderoi dhe vlerësoi lartë edhe punën e instruktorëve dhe oficerëve drejtues të këtij trajnimit. Për pjesëtarët të cilët kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata, kurse për më të dalluarit shpërblime, po ashtu me

këtë rast u ndanë mirënjohje për instruktorët e këtij trajnimit.

Në ceremoni të pranishëm ishin edhe ushtruesi i detyrës së komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë, kolonel Xhevahir Geci, ushtruesi i detyrës së shefit të Shtabit të BRSH-së, major Ejup Maqedonci, komandantët e tri Batalioneve të Reagimit të Shpejtë, përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Istog, Drejtorja e Qendrës së Burgut të Dubravës, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Instrukturë të Forcave të Armatosura të Polonisë trajnojnë pjesëtarë të FSK-së

Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 29 maj, u bë ceremonia e certifikimit të 16 pjesëtarëve të njësisve të ndryshme të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët ndoqën një trajnimin tre ditor "Mësimet e mësuara" nga ekipi mobil i instruktorëve të Komandës Operacionale të Forcave të Armatosura të Polonisë. Me këtë rast, shefi i

Shtabit të KFT-së, koloneli Naim Haziri, falënderoi Ekipin e Instrukturëve të Polonisë, për bashkëpunimin me FSK-në, për të shtuar se: "është shumë e rëndësishme për një institucion me i nda përvojat e përbashkëta për ne. Faleminderit juve, faleminderit shtetit tuaj dhe ushtrisë suaj, për mbështetjen e vazhdueshme që po jepni shtetit tonë dhe në veçanti

Forcës së Sigurisë së Kosovës". Ndërsa, kolonel Zabek Zbignjev u shpreh shumë i kënaqur me bashkëpunimin në mes FSK-së dhe instruktorëve të Forcave të Armatosura të Polonisë. Ai, tha se: "ishte një bashkëpunim mjaft i mirë, ku shkëmbyem përvojat tona dhe sollëm praktikat tona për "mësimet e mësuara" sipas standardeve të NATO-s".





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-46 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 9, pika 9.1, neni 13, dhe Rregulloren Nr. 02/2013 për Rekrutimin në FSK, neni 12, si dhe duke pasur për bazë ofertën e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, ofertën e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, si dhe ofertën e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

KONKURS

Për rekrutimin e kadetëve për vitin 2015/2016

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlihen me FSK-në dhe po ashtu do të veprojë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë: Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes. Kjo do të përfshijë operacionet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku do të fitohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regionale apo ndërkombëtare; të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) bën pranimin e kadetëve të cilët do të studiojnë në këto qendra universitare;

- 1. Forca e Sigurisë së Kosovës;**
-Qendra për Studime Universitare/ Universiteti Amerikan në Kosovë;
- 2. Republika e Turqisë (Akademia Ushtarake);**
-Akademia Ushtarake Tokësore
-Akademia Ushtarake Mjekësore
- 3. Republika e Kroacisë (Akademia Ushtarake/Universiteti i Zagrebit);**
-Lidershipi dhe Menaxhmenti Ushtarak
-Inxhinieria Ushtarake
- 4. Republika e Maqedonisë**
-Akademia Ushtarake

Kandidati që aplikon për praninë në Qendrën për Studime Universitare në FSK duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë kryer shkollën e mesme,
- Të mos jetë i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Të jetë i moshës 18 - 21 vjeçar në datën e aplikimit.

Testet që aplikohen për praninë në Qendrën për Studime Universitare në FSK;

- Ese në gjuhën angleze,
- Testi i aftësive në formën e testit të përgjithshëm të inteligjencës,
- Testi Pre-TOEFL,
- Testi fizik,
- Intervista,
- Verifikimi,
- Kontrollimi mjekësor,
- Testi TOFEL,
- Java Zero,
- Testi për udhëheqje (lidership).

Kandidati që aplikon për praninë në Akademinë e Ushtarake Tokësore dhe Akademia Ushtarake Mjekësore e Republikës së Turqisë duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë kryer shkollën e mesme (kërkohen njohuri të mira matematikë, fizikë dhe kimi),
- Të mos jetë i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Të jetë i lindur pas datës 30 gusht 1994,
- Të jetë 21 vjeç më së shumti,
- Të mos jetë i martuar, i fejuar apo i divorcuar si dhe të mos jetë në lidhje bashkëjetese.
- Të jetë në gjendje të mire shëndetësore dhe pa deformime trupore.

Testet që aplikohen për praninë në Akademinë e Ushtarake Tokësore dhe Akademia Ushtarake Mjekësore e Republikës së Turqisë;

- Testi i Gjuhës Angleze-Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme,
- Testi i aftësive në formën e testit të përgjithshëm të inteligjencës,
- Testi fizik,
- Testi Kualifikues Akademik (në gjuhën turke),
- Testi në gjuhën turke,
- Intervista,
- Kontrolli Mjekësor.

Kandidati që aplikon për praninë në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të jetë lindur më 1993 ose më vonë,
- Të ketë përfunduar shkollën e mesme,
- Të mos jetë i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Të plotësoj kriteret mjekësore, psikologjike, fizike dhe të sigurisë,
- Njohuri të mirë, në të shkruar, në të folur dhe në të kuptuar të gjuhës kroate,
- Njohuri të gjuhës angleze (e dëshirueshme).

Testet që aplikohen për praninë në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë;

- Testi në gjuhën angleze- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme,
- Testi me shkrim i njohurive në gjuhën kroate,
- Testi fizik,
- Testi i aftësive në formën e testit të përgjithshëm të inteligjencës,
- Kontrollimi mjekësor.

Kandidati që aplikon për praninë në Akademinë e Ushtarake të Republikës së Maqedonisë duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë kryer shkollën e mesme,

- Të mos jetë i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Të jetë i moshës 18 - 21 vjeçar në datën e aplikimit.

Testet që aplikohen për praninë në Akademinë e Ushtarake të Republikës së Maqedonisë;

- Testi i aftësive në formën e testit të përgjithshëm të inteligjencës,
- Testi fizik,
- Testi me shkrim i njohurive në gjuhën serbe,
- Intervista,
- Kontrollimi mjekësor.

Dokumentet për aplikim në QSU, në Akademinë Ushtarake Tokësore dhe Akademinë Ushtarake Mjekësore të Turqisë, dhe në Akademinë Ushtarake të Republikës së Maqedonisë;

- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon),
- Diploma e shkollës së mesme apo dëshmia e diplomimit së bashku me dëftesat për të gjitha vitet e shkollimit të mesëm(kopje e vërtetuar),
- Ekstrakti i lindjes,
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës,
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

Dokumentet për aplikim në Akademinë e Ushtarake/Universiteti i Zagrebit i Republikës së Kroacisë;

- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon),
- Diploma e shkollës së mesme apo dëshmia e diplomimit së bashku me dëftesat për të gjitha vitet e shkollimit të mesëm(kopje e vërtetuar),
- Ekstrakti i lindjes,
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës,
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm),
- Dëshmi e shtetësisë me të cilën kandidati aplikon (kopje të pasaportës e certifikuar nga Noteri Publik),
- Dëshmi e mbarimit të shkollës së mesme- kopje të certifikatave të shkollës për secilin vit të shkollës së mesme me përkthim të certifikuar në gjuhën Kroate,
- Kopje e diplomës së shkollës së mesme me përkthim të certifikuar në gjuhën Kroate,

Shënim;

- Kandidatët të cilët i përmbushin kriteret tjera të konkurrencës të parapara me konkursin për rekrutim, do të mund të marrin pjesë në procesin e testimit edhe në rast se nuk kanë arritur t'i nënshtrohen Testit Kombëtar të Maturës Shtetërore. Kandidatët duhet t'i sjellin diplomat e përfundimit të shkollës së mesme si në vijim;
- Kandidatët të cilët aplikojnë për studime në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së dhe në Akademitë përkatëse të Republikës së Turqisë dhe Maqedonisë, duhet t'i sjellin diplomat e shkollës së mesme më së largu deri më 15 korrik 2015,
- Kandidatët të cilët aplikojnë për studime në Akademinë Ushtarake/Universiteti i Zagrebit të Republikës së Kroacisë duhet t'i sjellin diplomat e shkollës së mesme më së largu deri më 30 qershor 2015.
- Kandidatët të cilët nuk mund t'i sjellin diplomat e shkollës së mesme sipas afateve të lartpërmendura, do të largohen nga procesi i mëtejshëm i konkurrencës.
- Për t'u marrë në konsideratë gjatë aplikimit, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kohëzgjatja e studimeve

Forca e Sigurisë së Kosovës;
-Qendra për Studime Universitare/ Universiteti Amerikan në Kosovë- 4 vite

Republika e Turqisë (Akademia Ushtarake);
-Akademia Ushtarake Tokësore -4 vite
-Akademia Ushtarake Mjekësore -6 vite

Republika e Kroacisë (Akademia Ushtarake/Universiteti i Zagrebit);
-Lidershipi dhe Menaxhmenti Ushtarak -4 vite
-Inxhinieria Ushtarake -4 vite

Republika e Maqedonisë
-Akademia Ushtarake - 4 vite

Vlerësimi dhe përzgjedhja:

- Kandidatët do të vlerësohen edhe sipas rezultateve gjatë shkollimit të mesëm dhe sipas vlerës së testeve në përqindje.
- Kandidatët duhet të kenë rezultate të larta gjatë shkollimit dhe në Testin Kombëtar të Maturës, të cilat do të vlerësohen si në vijim;
 - Nota mesatare gjatë shkollimit; nota 5=10 pikë, nota 4=9pikë, nota 3=8 pikë, nota 2=7 pikë,
 - Suksesi në katër vitet e shkollimit; nota 5=10 pikë, nota 4=9pikë, nota 3=8 pikë, nota 2=7 pikë,
 - Suksesi në Testin Kombëtar të Maturës; rezultati 90/100%=10 pikë, rezultati 80/90%=9 pikë, rezultati 70/80%=8 pikë, rezultati 60/70%=7 pikë, rezultati 50/60%=6 pikë.

Vlera për testet e shprehur në përqindje do të jetë:

- Ese në gjuhën angleze=10%
- Testi IQ=20%
- Testi Pre-TOEFL=10%
- Testi fizik=10%
- Intervista=20%
- Testi TOEFL=30%

Vlerat e testeve për kandidatët që aplikojnë për praninë në Akademinë Ushtarake Tokësore dhe Akademinë Ushtarake Mjekësore të Turqisë, Akademinë Ushtarake/Universiteti i Zagrebit të Republikës së Kroacisë, dhe në Akademinë Ushtarake të Republikës së Maqedonisë, mund të ndryshohen dhe përcaktohen nga Bordi Përzgjedhës.

Afati i konkurrencës;

Afati i konkurrencës për kandidatët të cilët konkurrojnë për studime në Qendrën për Studime Universitare në FSK, Akademinë Ushtarake Tokësore dhe Akademinë Ushtarake Mjekësore të Turqisë, si dhe Akademinë Ushtarake të Republikës së Maqedonisë është prej datës **01.06.2015 deri më 19.06.2015.**

Afati i konkurrencës për kandidatët të cilët konkurrojnë për studime Akademinë Ushtarake/Universiteti i Zagrebit të Republikës së Kroacisë është prej datës **01.06.2015 deri më 10.06.2015.**

Si të aplikoni;

Formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore, apo në ueb faqen e MFSK-së, www.mksf-rks.org, apo www.rks.gov.net/mfsk ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në këtë adresë: **Komanda e Forcave Tokësore, Kazerma „ Adem Jashari”, porta nr. 1, Prishtinë,** në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038-603-355/199.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për kadetë të FSK-së, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.